



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:057857

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05632939

KPPP.nr.764/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “As Project”, me NRB:70582430, me seli në Prishtinë, rruga “UÇK” nr.1/12, kundër debitorit “Arti Group” SH.P.K., me NRB: 70800225, me seli në Prishtinë, rruga “Kerem Leton”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përbarimor P.nr.19/17 të datës 17.01.2017 të Përbaruesit Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Arti Group” SH.P.K., ANULOHET urdhri përbarimor P.nr.19/17 i datës 17.01.2017, i Përbaruesit Privat Afet Mjeku dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “As Project”, ka caktuar urdhrin P.nr.19/17 të datës 17.01.2017, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. AS-005/2016 të datës 01.12.2016, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 5,440.00 €, me kamatë prej 8 % nga dita e lejimit të përbarimit e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, në të kundërtën realizimi i përbarimit të bëhet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përbaruesit privat, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit , deri në përmbushjen e borxhit të kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se faturat mbi bazën e se cilës është lejuar përmbarimi nuk paraqet dokument të besueshëm ngase fatura nuk i është dorëzuar debitorit personalisht, mes kreditorit dhe debitorit ka pasur raporte kontraktuale ku janë paraparë obligimet kontraktuale, obligime këto të cilat debitori i ka përmbushur në tërësi ndaj kreditorit, gjë që shihet edhe në barazimin e kreditorit, ndërsa kreditori faturën e ka lëshuar për projektin e njëjtë për të cilin debitori veç se ka bërë pagesën e obligimeve ndaj kreditorit. Tutje ka theksuar se debitori e ka njoftuar kreditorin se nuk ka asnjë borxh ndaj kreditorit, dhe se për këtë çështje kreditori kërkesën e tij ta kërkojë përmes padisë pranë gjykatës kompetente. Gjykatës i ka propozuar që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumën 104.00 €.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se debitori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi se e ka paguar borxhin ndaj kreditorit sipas faturës e cila është objekt i kësaj procedure, lidhur me kamatën të cilën e konteston debitori e njëjta është e përcaktuar me nenin 382 paragrafi 1 dhe 2. Tutje ka shtuar se debitori prapësimin e ka paraqitur vetëm për ta zvarritur procedurën. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.171/17, të datës 31.10.2017, e ka pranuar prapësimin e debitorit, si dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.19/17 të datës 17.01.2017, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat Afet Mjeku.

Kreditori me datë 10.11.2017, ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë ta ndryshoj.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1292/22 të datës 03.04.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. AS-005/2016 e datës 01.12.2016, në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti Fatura Nr. AS-005/2016 e datës 01.12.2016, në bazë të së cilës është lejuar propozimi përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin dhe as vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk kanë dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori.

Andaj, duke qenë së debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, si të tilla, të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale – debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga faturat.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e kreditorit se Fatura Nr. AS-005/2016 e datës 01.12.2016, debitorit i është dorëzuar përmes postes rekomande, mirëpo nga shkresat e lëndës rezulton se debitorit nuk i është dërguar fatura përmes postës rekomande, përkatësisht në shkresat e lëndës nuk ka prova se e njëjta i është dërguar përmes postës rekomande.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.764/23, datë 29.04.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.